



2019

Buxheti

për qytetarin



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

Shënim

Ky material mbështetet në Ligjin për Buxhetin e vitit 2019 të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në 3 dhjetor 2018. Ky material paraqet një variant të shkurtuar dhe jo shterues të buxhetit 2019.

Përdorimi i tekstit

Përdorimi i tekstit dhe të dhënave të paraqitura në këtë material, me kusht që të referohen pa ndryshim, lejohet me citimin e burimit:

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Modifikimi i tekstit

Në rast se teksti, të dhënat apo grafikët e paraqitur këtu përdoren për të gjeneruar materiale apo të dhëna të ndryshme, preferohet citimi:

Bazohet në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Informacione të tjera

Projektligji i plotë për Buxhetin 2019 dhe tabelat përkatëse janë botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DHE EKONOMISË

www.financa.gov.al

Për informacione apo sqarime të nevojshme mund të drejtoheni në adresën:

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë

e-mail: konsultimepba@financa.gov.al

Paraqitja grafike nga Grid Cartels.

Përmbajtja

Mesazh për lexuesin	4
Ekonomi më e fortë	6
Tregues Pozitivë Makroekonomikë	7
Perspektiva ekonomike	8
Punësimi është në rritje	9
Konsolidimi i shërbimeve publike themelore	10
Shëndet për të gjithë	10
Çdo fëmijë në shkollë	11
Mbrojtje sociale për çdo qytetar në nevojë	12
Siguri dhe drejtësi për qytetarët	13
Nxsisim zhvillimin ekonomik dhe mbështesim rajonet	14
Ndërtojmë Shqipërinë	14
Mbështesim ekonominë rurale	16
Promovojmë Shqipërinë si destinacion investimi	17
Nga vijnë paratë e buxhetit?	18

Mesazh për lexuesin

Buxheti 2019, e gjithë vëmendja për qytetarët



Z. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
dhe Ekonomisë

Buxheti për qytetarët përmban një përshkrim të thjeshtuar të propozimit të buxhetit të shtetit për vitin 2019. Buxheti 2019 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritimit në Bashkimin Europian. Ai bazohet në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vazhduar **trajktoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB**. Ky objektivi i politikës fiskale është tejet i rëndësishëm për të siguruar ambientin makroekonomik për një **rritje të qëndrueshme ekonomike mbi nivelin prej 4%**, dhe rritjen e punësimit. Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 5.1% e PBB**.

Buxheti 2019, avanco **investime të mëdha publike** në vepra të rëndësishme infrastrukturore, në arsim e shëndetësi gjithashtu. Buxheti 2019, është një **buxhet social**, që garanton mbështetje të drejtpërdrejtë për cdo kategori, që nga instrumenti **i rritjes së pagave** për mbi 65 mijë të punësuar në sektorin publik, tek **bonusi për bebet e porsalindura**, e deri tek heqja e TVSH së inputeve në bujqësi, duke e bërë këtë sektor me zero taksa. Në pesë vitet e fundit, qeveria ka synuar uljen e taksave dhe ngarkesës fiskale për qytetarët dhe bizneset. Rritja e të ardhurave është orientuar kryesisht nga zgjerimi i bazës së tatueshme, lufta ndaj informalitetit dhe përmirësimi i administrimit tatimor. Edhe buxheti i vitit 2019 synon të shpërndajë në mënyrë më të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e aksesit, thjeshtimi i procedurave administrative për sipërmarrjen e qytetarët, rritja e mirëqenies, ulja e borxhit publik dhe mirëmenaxhimi i financave publike përbëjnë **platformën e garantuar nga ky buxhet**

Shpenzimet buxhetore për periudhën 2019-2021

do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe veçanërisht për këtë vit, mbështetjen e sektorit të bujqësisë. Rijetëzimi rural do të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për zhvillimin rajonal në këtë mandat katërvjeçar. Për këtë qëllim, programi **100 Fshatrat** do të synojë të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë. Programi konsiston në konsolidimin e investimeve publike, atyre të donatorëve dhe të investimeve private, në hapësirën e 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomik-sociale,

të agroturizmit e turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore.

Buxheti 2019 financon politika të reja për rritjen e pagave në sektorët shëndetësi, arsim parauniversitar, mbrojtje dhe sistemi penitenciar me një rritje prej 7% si dhe të diplomatëve me një rritje 20%.

Ai realizon gjithashtu **lehtësimin e barrës fiskale**, nga e cila përfitojnë mbi 15 mijë punëmarrës nga ulja e normës së tatimit mbi pagat e nivelit të mesëm; 11 mijë biznese përfitojnë nga ulja e normës së tatimit mbi fitimin me 2/3; si dhe lehtësohet veprimtaria e qindra operatorëve ekonomikë në industrinë e fasonit, atë farmaceutike, makinerive bujqësore.

Politikat sociale mbeten në vëmendjen e qeverisë në këtë buxhet, me mbështetjen për familjet me politikën e re të **shpërblimit për çdo lindje** me synim përmirësimin e treguesit demografik të moshës mesatare të popullsisë nga e cila parashikohet të përfitojnë rreth 30 mijë familje; dhe financimit të ngritjes së shërbimeve shoqërore për personat me aftësi të kufizuara dhe gjithë individët e familjet në nevojë, krahas skemave të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuara.

Përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e aksesit, thjeshtimi i procedurave administrative për sipërmarrjen e qytetarët, rritja e mirëqenies, ulja e borxhit publik dhe mirëmenaxhimi i financave publike përbëjnë platformën e garantuar nga ky buxhet, mbi të cilën mbështetet aspirata europiane e qytetarëve shqiptarë.

Ekonomi më e fortë

Ekonomia shqiptare vijon rritjen me ritme më të larta se mesatarja e rajonit për të katërtin vit radhazi

Me planin ekonomik të qeverisë po krijohen vende të reja pune, po rriten investimet dhe financat publike po konsolidohen – duke krijuar mundësi të garantojmë shërbimet publike themelore për të cilat kanë nevojë qytetarët dhe familjet e tyre.

Ky buxhet mbështetet mbi perspektivën afatgjatë të ekonomisë, që të sigurojë se përfitimet nga rritja më e madhe ekonomike do të ruhen dhe do të kenë efekt mbi të gjithë qytetarët.

Në bazë të këtij plani ulet barra fiskale për të nxitur dhe për të shpërblyer qytetarët që punojnë, për të mbështetur bizneset që investojnë dhe të krijojnë më shumë vende pune. Buxheti 2019 garanton më shumë punësim – 30 mijë vende të reja pune, politika nxitëse fiskale dhe skema mbështetëse të punësimit dhe aftësisimit profesional.

Rritje pagash dhe ulje e taksave për qytetarët që punojnë

Rritjen e pagave në sektorët shëndetësi, arsim parauniversitar, mbrojtje dhe sistemi penitenciar me një rritje prej 7% dhe trupit diplomatic, nga e cila përfitojnë:


- 64 865 punonjës
- Me një kosto prej 3 miliardë lekë në vit.

Indeksi i pensioneve:

- 2,45 miliardë lekë më shumë për indeksimin e pensioneve

Ulje e barrës tatimore për të punësuarit me nivel të mesëm pagash:

- Ulje e normës tatimore nga 15% në 13% për 15,400 punëmarrës me pagë nga 130.000 lekë/muaj në 150.000 lekë/muaj, që taten me normën 13%.



Tregues Pozitivë Makroekonomikë

Prodhimi i Brendshëm Bruto

1752
miliardë lekë

Rritja Reale

4,3%
PBB

Të ardhurat dhe shpenzimet

Buxheti 2019 ul deficitin fiskal për të tretin vit radhazi, në nivelin më të ulët të synuar përgjatë dy dekadave të fundit. Borxhi publik vijon trajektoren rënëse prej katër vjetësh, në nivelin 64,9% të PBB-së.

Të ardhurat

486,5
miliardë lekë

Shpenzimet

519,4
miliardë lekë

Deficiti Buxhetor

1,9%
PBB

Mbështesim biznesin për të nxitur investimet dhe krijuar vende të reja pune:

Ky buxhet garanton ekonomi më të shëndoshë, rritje të vendeve të punës dhe të investimeve publike.


Lehtësim **i barrës fiskale** për bizneset e vogla dhe investitorët e kapitalit, për të mundësuar më shumë investime në ekonomi:

- 20 mijë biznese ose mbi 50 mijë investitorë të kapitalit përfitojnë nga ulja e normës së tatimit mbi dividendin;
- 11 mijë biznese përfitojnë nga ulja e normës së tatimit mbi fitimin me 2/3;
- Incentiva dhe stimuj tatimorë për industri dhe sektorë prioritarë si bujqësia, fasoni, farmaceutika
- 88,8 miliardë lekë investime kryesisht për infrastrukturën e transportit, energjisë dhe shërbimeve publike
- Ndërtimi i një ekonomie të fortë dhe inovative nëpërmjet përmirësimit të klimës së biznesit

Përparësitë tona


Buxheti 2019 investon burime në rritje në përparësitë kyç të qeverisë.

- Konsolidimi i shërbimeve jetike: shëndetësia, arsimi dhe aksesimi në drejtësi
- Nxitje e zhvillimit ekonomik dhe mbështetje për rajonet: programe të zhvillimit ekonomik rajonal e rural
- Ndërtimi i infrastrukturës moderne: Infrastruktura rrugore, e ujit, e turizmit dhe mjedisit
- Politika sociale: shërbime shoqërore për kategoritë në nevojë dhe mbështetje për familjet e reja



Perspektiva ekonomike

Rritja ekonomike parashikohet të rritet mbi 4% në periudhën afatmesme. Ekonomia shqiptare parashikohet të rritet me ritme më të larta se mesatarja e rritjes së vendeve të rajonit.



Edhe punësimi është në rritje!

Rritja domethënëse ekonomike e parashikuar për vitin 2019 krijon më shumë punësim me hapjen e mbi 30 mijë vendeve të reja të punës, duke rezultuar në rënien e nivelit të papunësisë nën 12% në 2019-ën krahasuar me 12.9% mesatarisht në 2018-ën.

Buxheti 2019 vijon të mbështesë krijimin e vendeve të reja të punës me politika incentivuese fiskale si dhe me një skemë më efektive të punësimit dhe aftësimin profesional . 809 mijë persona, ose 7.3% më shumë punëmarrës se në 2018-ën kontribuojnë në skemën e sigurimeve shoqërore – ulja e informalitetit në punësim garanton edhe kushte më të mira pune për qytetarët.

1 KONSOLIDIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE THEMELORE

Mbështesim më shumë mundësi për një jetë më të mirë. Buxheti 2019 investon për të siguruar akses në shërbime cilësore publike për të gjithë qytetarët



SHËNDETËSIA

Shëndet për të gjithë

Buxheti 2019 vijon politikat për mbulimin universal me shërbim cilësor, diagnostikimin dhe parandalimin e sëmundjeve dhe shtimin e gamës së medikamenteve të rimbursueshme. Investimet në infrastrukturën shëndetësore për të siguruar aksesin e qytetarëve në shërbime themelore ku dhe kur t'u nevojitet janë prioritare:

E gjithë vëmendja për njerëzit:

- Shërbimi i kontrollit bazë (check-up) falas për 475 mijë pacientë në vit, 50% burra e 50% gra
- Mbi 45% më shumë gra mbi 35 vjeç që përfitojnë nga shërbimet falas të depistimit të kancerit të gjirit dhe më shumë raste të kancerit të gjirit të trajtuara
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit shëndetësor

parësor në konsultoret e gruas dhe fëmijës, duke ofruar shërbim cilësor dhe gjithëpërfshirës për më shumë se 50% të nënave të reja dhe mbi 80% të foshnjave vajza e djem

- Trajtimi me recetë rimbursimi për mbi 475 mijë pacientë në vit

Rritja e numrit të pacientëve të trajtuar:

- nga 6.4 milionë në 6.7 milionë vizita në kujdesin parësor deri më 2021
- nga 290 mijë më 2018, në 310 mijë pacientë të trajtuar për vitin 2019 e 330 mijë më 2021
- 200 pacientë më shumë që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë
- Nga 170 mijë seanca dialize në 2018, në 234 mijë në vitin 2021

Infrastrukturë më e mirë në çdo skaj të vendit:

- Fuqizimi i spitaleve rajonale dhe rijetësimi i materniteteve
- Rehabilitimi dhe pajisja e plotë e 100 qendrave shëndetësore
- 20% më shumë investime në shëndetësi se më 2018
- Modernizim i QSUT më spitalin e ri të kirurgjisë dhe vijimin e ndërtimit të spitalit të ri të sëmundjeve të brendshme & pediatriisë.

Mjekë për Shqipërinë:

- 1 miliard lekë për rritjen e pagave për 18,415 punonjës në shëndetësi:

Sigurimet shëndetësore:

- 41,9 miliardë lekë, ose 2,4% e PBB nga 40,4 miliardë lekë në 2018
- Financim mbi 100 miliardë lekë për barnat e rimbursueshme

Çdo fëmijë në shkollë

Buxheti 2019 i jep vëmendje të veçantë kërkesës në rritje për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, zhvillimit të hershëm të fëmijëve

Buxheti 2019 i jep vëmendje të veçantë kërkesës në rritje për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, zhvillimit të hershëm të fëmijëve; rrit financimet për arsimin parashkollor në dispozicion të bashkive për të mundësuar e uljen e numrit të fëmijëve për mesues në kopshte të shkollave. Mbështetje për familjet në nevojë me sigurimin e transportit për më shumë fëmijë të mësuesve dhe programeve të veçanta si ai i shkollave komunitare dhe kujdes për nxënësit me nevojë të veçanta nëpërmjet aksesit më të mirë të rritjes së numrit të mësuesve ndihmës. Buxheti investon në shkollat të reja, ngritjen profesionale të mësuesve, rritjen e cilësisë së teksteve shkollore dhe sigurimin e teksteve falas për të gjithë fëmijët në arsimin fillor.

Nxënie gjithëpërfshirëse dhe cilësore




- Ndërtime të reja, apo rikonstruksione për mbi 170 objekte arsimore, ose rreth 1500-1700 klasa / laboratorë mësimore në arsimin parauniversitar
- Transport i 28-30 mijë nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 10 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi
- Blerje e teksteve shkollore për rreth 190 mijë nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë;
- 1000-1400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë me kuota të ushqimore
- Rritje mbi 48% e numrit të vajzave në zonat rurale dhe urbane që ndjekin arsimin bazë publik
- Rritje e numrit të vajzave

që regjistrohen në arsimin e mesëm të lartë publik, pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm

- Rritje mbi 46% e vajzave që ndjekin arsimin e mesëm të lartë publik (mbi 53% vajzat nga zonat rurale)
- Rritja në përqindje të studenteve vajza të mbështetura me fond ekselence, për të mundësuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në fondet e shkencës
- Edukimin nëpërmjet sportit në shkolla, për përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për të rinjtë

Vëmendje për mësuesit:

- 1,4 miliardë lekë shtesë për paga për 35,783 staf mësimor
- 9,1% rritje e fondeve për edukatorët në arsimin parashkollor



Rritje për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës

Ofrimi i teksteve shkollore falas për rreth 190 mijë nxënës të arsimin

1,4 miliardë lekë shtesë për paga për 35,783 staf mësimor

PAKETA SOCIALE

Mbrojtje sociale për çdo qytetar në nevojë



Buxheti 2019 mbështet individët dhe familjet në nevojë

Buxheti 2019 mbështet individët dhe familjet në nevojë nëpërmjet shënjestrimit më të mirë të sistemit të ndhmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe veçanërisht fokus në ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve shoqërore mbarë vendit. Krijimi i fondit social synon mbështetjen e njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike me paketa sociale shëndetësore.

Programet e riintegritit social do të synojnë mbështetjen e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale.

Mbështetje për punësim dhe shërbime sociale:

- Skema e re e vlerësimit dhe programet e ri-integritit social mbështesin rreth 3000 familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike deri në vitin 2021, nga ku mbi 12% të përfituesve janë gra kryefamiljare
- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre do të rritet nga 160 mijë në 167 mijë në vitin 2021
- Rritjen mbi 80% të numrit të përfituesve të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.
- Shtimit të numrit të grave dhe vajzave në nevojë të ri integruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social

Mbështesim familjet e reja dhe individët në nevojë:

- Bonusi I bebes: 2 miliardë lekë për shpërblimin për çdo lindje, për të mbështetur rreth 30 mijë familje në vit
- Pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar: 20,5 miliardë lekë në vit
- Pagesat e papunësisë dhe mbështetjen për punësim: 1 miliard lekë në vit
- 1 miliard lekë për ish-të përndjekurit

Siguri dhe drejtësi për qytetarët

Ky buxhet priorizon jetësimin e Reformës në Drejtësi; legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve dhe zonave informale; garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe sigurimin e ri-integrimit të tyre në shoqëri, edhe nëpërmjet rritjes së performancës në shërbimin e provës. Garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, janë prioritetet për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, duke përmirësuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet, në funksion të një kontrolli më efektiv dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

Drejtësi për ish-pronarët dhe zgjidhje e problemeve sociale:

- Sigurimi i një numri praktikash legalizimi pasurish informale prej 25,000 raste në vit;
- Realizimi i sigurt i të

ardhurave nga legalizimi me një vlerë prej 1,15 miliardë lekë çdo vit;

- Realizimi i skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 68% që është aktualisht në 99% në 2021;
- 5 miliardë lekë, ose 0,3% e PBB-së për Fondin për Pronarëve i cili rritet çdo vit nga 1,89 miliardë lekë që ishte më 2013

Siguri në rrugë dhe shërbim policor miqësor:



- Përmirësimi rrënjësor të sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të qytetarëve dhe sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë në masën 1% çdo vit, nga 1959 raste që parashikohen deri në fund të vitit 2018;
- Rritjes së nivelit të sigurisë

publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet përmes rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit (nga 296,276 shërbime në vitin 2018 në 362,950 shërbime në vitin 2021)

- Reduktimi i kohës së reagimit të shërbimeve policore (nga 23 minuta në vitin 2018 në 15 minuta në vitin 2021).
- Shtimin e numrit të grave dhe vajzave të diplomuara në Akademinë e Policisë deri në 41% ndaj totalit në vitin 2021, me qëllim realizimin e barazisë gjinore edhe në forcat e Policisë

Vëmendje për gratë dhe familjet:

- Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje nga 20 min në 2018 në 14 minuta në 2021
- Rritja e numrit të masave të menjëhershme mbrojtëse për gratë dhe vajzat e dhunuara në masën 10%



Përmirësimi rrënjësor të sistemit të kontrollit rrugor

0,3% e PBB-së për Fondin për Kompensimin në Vlerë të Pronarëve

Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje

2 NXISIM ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE MBËSHTESIM RAJONET

Buxheti 2019 investon në zhvillimin ekonomik dhe produktivitetin, me fokus në mbështetjen e ekonomive rurale dhe rajonale



INFRASTRUKTURA DHE PRODUKTIVITETI

Ndërtojmë Shqipërinë

Buxheti 2019 investon në infrastrukturën e nevojshme për të rritur zhvillimin ekonomik. Ky buxhet garanton 5% të PBB-së në investime, nga të cilat 21 miliardë lekë për projekte të rëndësishme të transportit rrugor në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve në të gjithë vendin, në vijim të projekteve të nisura që me buxhetin 2018 si Projekti "1 miliard" me partneritet publik – privat:

Transporti Rrugor

- Përfundimi i akteve rrugore nacionale si: Rruga e Arbrit, Thumanë – Vorë – Kashar, Kashar – Rrogozhinë; Milot – Ballëdren; Orikum – Dukat brenda vitit 2021 nëpërmjet Partneritetit Publik Privat në kuadër të projektit "1 Miliard";
- Rritja e sigurisë rrugore në

të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 23%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.

- Vazhdimi i financimit për akset rrugore

Furnizimi me ujë


Reforma në sektorin e ujit, është një nga prioritetet e Qeverisë. Ajo mbështetet në reformimin e mirëqeverisjes dhe orientimin e investimeve drejt performancës, si dhe drejt sigurimit të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë:

- Studim projektim i furnizimit me ujë dhe sistemim i ujrave të perdorura për zonat bregdetare –I, i cili do të japë në menyre të detajuar sasinë

e fondeve që do të nevojiten për investime për brezin e parë të bregdetit në vitet 2020 e vazhdim.

- Përmirësimi i infrastrukturës së ujrave të zeza në zonën bregdetare Vlorë
- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar rritet në 14 orë në ditë në 2021, nga 12.5 orë në ditë në vitin 2018;
- Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar në masën 20% në vitin 2021;
- Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë në vitin 2021;
- Financimi i projektit të ri "Përmirësimi i infrastrukturës së ujrave të zeza në zonën bregdetare Vlorë"

Ndërtojmë akse jetike për qytetarët dhe biznesin,
sigurojmë infrastrukturë ujore për qytetarët dhe turizmin



800 milionë
Ujttja dhe mbrojtja nga përmybtja

4,2 miliardë
Mirëmbajtje dhe siguri rrugore

10,5 miliardë
Infrastrukturë rajonale

8 miliardë
Furnizimi me ujë

Mbështesim ekonominë rurale

Krijojmë vende pune dhe perspektivë

Buxheti 2019 garanton mbështetjen e modernizimit të sektorit të bujqësisë nëpërmjet fondeve IPARD; garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas; nxitjen e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin; mbështetje për agroindustrinë; dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Zgjerim dhe modernizim i infrastrukturës së ujitje-kullimit:

- Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore së ujitur nga 63.8% në 68.1% të totalit potencial prej 360 mijë hektarë tokë në vitin 2021;
- Mundësimi i kullimit me ngritje mekanike me hidrovorë për 70 mijë hektarë tokë;

- Rehabilitimi/ndërtimi i rreth 16 km argjinatura të mbrojtjes nga përmytja dhe erozioni dhe mirëmbajtje vjetore të rrjetit kullues për 45 000 hektarë tokë si proces ciklik vjetor;

Zhvillimi rural:

- Ulja e tatimit mbi fitimin nga 15% në 5% për fermerët të inkorporuar në Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor


Rritja e skemave të mbështetjes për fermerët në zhvillimin rural:

- 2,6 miliardë lekë mbështetje e drejtpërdrejtë e buxhetit për fermerët, mesatarisht 3600 përfitues çdo vit
- Deri në 3 miliardë lekë mbështetje dhe investime direkte për fermerët nga skemat e mbështetjes nga fonde të Bashkimit Europian
- Rritje të numrit të grave fermere përfituese nga


skemat e mbështetjes, duke siguruar edhe informimin dhe këshillimin e tyre me aktivitete të dedikuara

Programi 100 fshatra:


- Koordinim i ndërhyrjeve zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomik-social, të agroturizmit dhe turizmit rural, natyrës dhe mjedisit dhe trashëgimisë kulturore
- Ulje e TVSH-së nga 20 % në 6 % për shërbimet që ofrohen në fermë (akomodim, ushqim etj);
- Përrjashtim i agrobiznesit nga "taksa e ndikimit në infrastrukture" për ndërtimet me destinacion agroturizmin
- Incentivimin e bizneseve që janë të licensuar dhe operojnë në fushën e agroturizmit duke reduktuar normën e tatimit mbi fitimin korporativ nga 15 % në 5 %;



Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore së ujitur



Rritja e mbështetjes financiare për fermerët



Ulje e TVSH-së nga 20% në 6% për shërbimet që ofrohen në fermë



ZHVILLIMI EKONOMIK

Promovojmë Shqipërinë si destinacion investimi

Buxheti 2019 përqendrohet edhe në promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh, rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare në tregun ndërkombëtar nëpërmjet granteve nga:

- Fondi i Konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021, nga ku 20% të përfituesve janë gra sipërmarrëse);
- Avancimi i mëtejshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit nëpërmjet granteve që i akordohen bizneseve të specializuara në këtë fushë nga Fondi i Inovacionit (75 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021, nga ku 40% të përfituesve janë gra);


- Nxitja e krijimit të bizneseve të reja në sektorë me potencial zhvillimi nëpërmjet Fondit Start-Up (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021, 80% të të përfituesve janë gra);
- Mbështetja e sipërmarrjeve të sektorit të artizanatit dhe zejtarisë me qëllim konsolidimin e tyre në treg dhe rritjen e numrit të të punësuarëve nëpërmjet "Fondit të mbështetjeje të biznesit kreativ", ku në total parashikohet të përfitojnë 85 SME vendase me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021, 90% e të cilëve janë biznese të zotëruara nga gratë).

Buxhetimi gjinor

Buxheti i vitit 2019 ndër të tjera synon të rrisë transparencën ndaj qytetarëve duke i bërë ata pjesë të procesit, me anë të diskutimeve dhe propozimeve për ndërhyrje konkrete në fusha ku, pjesëmarrja qytetare mund të japë vërtet kontribut të vlefshëm. Gjithashtu, ky buxhet është një pasqyrim i përpjekjeve dhe angazhimeve konkrete të Qeverisë për të adresuar problemet e pabarazive gjinore në të gjithë sektorët. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, i integruar në të gjitha fazat e buxhetit publik, vijon të jetë për të tretin vit radhazi një pjesë shumë e rëndësishme e integritimit gjinor, jo vetëm në politika, por edhe në buxhetet që i përkthejnë ato në masa konkrete. Për vitin 2019, janë angazhuar 32,7 miliardë lekë, ose rreth 6,3% e totalit të shpenzimeve buxhetore për realizimin e politikave me bazë gjinore"


Taksa më të ulëta për bizneset e vogla

SOT



NESËR

91% e sipermarrjeve ne vend do te paguajne 0 ose 5%



Nga vijnë paratë e buxhetit?

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit 2019 pritet të jenë 486,5 miliardë Lekë, ose 27,8% e PBB-së dhe 4,7% më të larta se një vit më parë. Shpenzimet gjithsej për buxhetin 2019 janë parashikuar në nivelin 519,4 milionë Lekë, ose 29,6% e PBB-së dhe 4,5% më të larta se një vit më parë. Të ardhurat tatimore janë 447 miliardë, ose 25,5% e PBB-së.

